

Dekanati është organ kolegjal që drejtohet nga dekani dhe përbëhet nga:

- a) Dekani;
- b) Zëvendësdekani;
- c) Drejtuesit e njësive bazë.

Mënyra e thirrjes, e funksionimit dhe e organizimit të dekanatit zhvillohet në përputhje me rregulloren e fakultetit.

Dekanati harton planin strategjik të zhvillimit të njësisë kryesore, mbështetur në propozimet e njësive bazë të tij.

Dekanati koordinon veprimtaritë e njësive bazë të fakultetit dhe i orienton ato gjatë ushtrimit të detyrave të tyre.

Marrëdhëniet mes anëtarëve në dekanat përcaktohen në rregulloren e brendshme të njësisë kryesore.

Dekanati shqyrton vendimet e njësisë bazë për hapjen, ndryshimin dhe mbylljen e programeve të reja të studimit dhe ia propozon Senatit Akademik për veprime të mëtejshme.

Dekanati shqyrton e miraton, në një mbledhje të hapur për personelin akademik administrativ dhe për studentët, raportin vjetor të dekanit për veprimtarinë mësimore, kërkimore dhe financiare të njësisë kryesore.

Dekanati miraton listën e periodikëve shkencorë ku do të pajtohet fakulteti, si dhe propozon titujt e librave që do të blihen për bibliotekën e fakultetit, sipas kërkesave të strukturave përbërëse.

Dekanati i përcjell Rektoratit planin strategjik të zhvillimit të njësisë kryesore dhe mbikëqyr realizimin e tij.

Dekanati miraton rregulloren e njësisë kryesore.

Dekanati miraton në parim marrëveshjet që synon të lidhë njësia kryesore përkatëse me të tretë, përpara se të nënshkruhen nga dekani, vetëm pasi të marrë miratimin e Senatit Akademik.

Dekanati i përcjell për miratim Senatit Akademik propozimet e njësive bazë për dhënien e titujve dhe vlerësimeve të tjera të përcaktuara në statut.

Dekanati jep mendime këshillimore për çdo tematikë apo problematikë që prek funksionimin akademik dhe administrativ të fakultetit.

Dekanati mbledhet periodikisht dhe për çdo mbledhje mbahet procesverbal.

Dekanati shprehet me vendime dhe udhëzime për çështjet që merren në shqyrtim.

Dekanati ushtron funksione të tjera të parashikuara në Statut dhe akte të tjera të Universitetit.